



# NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C.

Part of BALFIN, Balkan Finance Investment Group

## NJOFTIM PUNE

**Balfin Group** është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitetet për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e hapsirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët.

NewCo Ferronikeli Complex L.L.C është pjesë e Balfin Group dhe operon në sektorin e Industrisë së Minierave.

**Pozicioni:** Saldues dhe Agjystator

**Departamenti:** Mirëmbajtje

**Lokacioni:** Drenas, Kosovë

### Përmbledhja e Pozicionit:

Është përgjigjës për kryerje profesionale sipas rregullave dhe standardeve të saldimit në aspektin e kualitetit, realizimit sa më efektiv të orarit të punës, për zbatimin e urdhëresave dhe akteve normative që kanë të bëjnë me sigurinë në punë.

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është i obliguar që t'i kryej punët në kohë dhe kualitet të lartë në përputhje me rregullat dhe udhëzimet në lëmin e teknologjisë së saldimit
- Vlerëson pajisjet, strukturat, materialet dhe specifikimet e punës për pozicionet dhe metodat e duhura të saldimit
- Bën kontrollim të rregullt të paisjeve makinerike sipas planit të aprovuar nga Udhëheqësi
- Vendos dhe operon një shumëllojshmëri të pajisjeve të saldimit
- Planifikon punën, sekuencat e operacioneve të saldimit, ndjek vizatimet dhe skicat
- Monitoron cilësinë e punës në të gjitha fazat e saldimit, duke bërë kontrolle dimensionale dhe vizuale dhe duke bërë teste
- Gjatë realizimit të punëve duhet të kujdeset për sigurimin e vendit të punës, të jetë i përgatitur me mjete dhe vegla të punës ashtu që puna të kryhet me sukses në çdo aspekt
- Sipas nevojës kryen edhe detyra tjera shtesë sipas kërkesës së udhëheqësit

### Kualifikimet dhe Aftësitë:

- Diploma e shkollës së mesme ose kualifikimi ekuivalent
- Çertifikatë e vlefshme për saldim nga një institucion i akredituar
- Përvojë minimale 2 vjeçare
- Njohuri të shkëlqyera për makinat e saldimit
- Aftësia për të lexuar dhe interpretuar skemat përkatëse
- Vëmendje e jashtëzakonshme ndaj detajeve.

### Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV-të e tyre së bashku me letër motivimi dhe dokumentet përcjellëse më së largu deri më 06/01/2020, në adresën e e-mailit [hr@ferronikeli.com](mailto:hr@ferronikeli.com) duke përcaktuar në subjekt pozicionin "**Saldues dhe Axhystator**"

\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe vetëm kandidatët që do të përzgjedhen në listen e ngushtë do të kontaktohen.



Besim Mala Street no.227, 13000 Gllgoc, Republic of Kosovo, Phone: + 383 (0)38 585 000, Fax: + 383 (0) 38 585 109

NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C. is part of BALFIN, Balkan Finance Investment Group

